



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT GJENERAL / KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE  
AUDITOR GENERAL

Nr.Doc: 23.1.5;6-2007-08

**RAPORTI I AUDITIMIT MBI TË HYRAT DHE  
SHPENZIMET E RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR  
MË 31 DHJETOR 2007**

Prishtinë, Tetor 2008

OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL\* GAZMEND ZAJMI # 59, PRISTINA 10000  
PHONE: +381 (0) 38 2535 163/251/221 \* FAX: +381 (0) 38 2535122

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Përmbledhje e përgjithshme
  - II. Hyrje
  - III. Historiku i RTK-së
  - IV. Fushëveprimi i auditimit
  - V. Qasja e auditimit
  - VI. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
  - VII. Auditimi i Brendshëm
- Anekset
- I. Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007

Lista e shkurtesave dhe fjalëve

AGJ	Auditorja Gjenerale
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
RTK	Radiotelevizioni i Kosovës
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KRRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

## I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

Në mendimin tonë, me përjashtim të disa mangësive të prezantuara më poshtë, RTK-ja kishte menaxhuar në mënyrë të duhur me të hyrat e mbledhura dhe shpenzimet e realizuara për vitin 2007, si dhe kishte vepruar në përputhshmëri me kornizën e vet rregullative gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta operative dhe financiare.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe përfshinë testimet dhe procedurat e tilla që ne i kemi konsideruar të nevojshme për të raportuar mbi menaxhimin financiar të RTK-së.

Raporti ynë i auditimit në Kapitullin VI, paraqet të gjeturat dhe një total prej 8 rekomandimeve në fushat në vijim:

- Menaxhimi Financiar
- Të hyrat nga participimet për Transmetuesin Publik
- Të hyrat nga Marketingu
- Pagat dhe Mëditjet
- Prokurimi
- Shpenzimet e udhëtimit
- Trajnimi i Stafit
- Auditimi i Brendshëm

## II. HYRJE

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm funksionon në bazë të Ligjit nr. 03/L-075 . Sipas nenit 3.2 të këtij Ligji Auditori Gjeneral (AGJ) në baza vjetore e kryen Auditimin e Rregullsisë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, Organizatave Buxhetore, duke përfshirë por pa u kufizuar, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrën e Presidentit të Kosovës ,çdo Ministri ose Agjenci Ekzekutive, Komunitat, Organet e Pavarura, Bankën Qendrore dhe subjektet tjera të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendët apo të ardhura tjera të pataksueshme për të, duke përfshirë por pa u kufizuar, Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudspersonin.

Sipas nenit 1 (përkufizimet) të këtij Ligji, Auditimi i Rregullsisë përkufizohet si verifikim i përgjegjësisë financiare, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë;
- Nëse të dhënat, sistemet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditimit të brendshëm;
- Ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të nxjerra nga institucioni ose entiteti që i është nënshtruar auditimit; si dhe
- Të gjitha çështjet të cilat rrjedhin nga auditimi ose kanë të bëjnë me të.

## III. Historiku i RTK-së

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është institucion publik i cili ofron shërbime publike në fushën e transmetimit të radios dhe televizionit. RTK-ja është subjekt juridik e themeluar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës me Ligjin Nr.02/L-47 i cili është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2006/14.

RTK-ja përbëhet nga Organi Qeverisës – Bordi i RTK-së dhe Organi Menaxhues – Drejtori i Përgjithshëm dhe Menaxhmenti i Lartë.

Bordi i RTK-së e aprovon Statutin e RTK-së, Rregulloren e punës, dhe publikon për çdo vit deri më 30 Mars, raportin vjetor financiar të të hyrave dhe shpenzimeve për vitin paraprak; ky raport është subjekt i auditimit të pavarur.

Aktet e përgjithshme të miratuara nga Bordi i RTK-së rregullojnë aktivitetet e përditshme dhe mënyrën se si kryhen veprimtaritë financiare dhe të kontabilitetit. Bordi i RTK-së miraton planet financiare, operative dhe zhvillimore.

RTK-ja financohet nga:

- Parapagimi për Transmetim Publik ;
- Kontratat me palët e treta për shërbime transmetuese,
- Shërbime të tjera programesh;
- Botimet e prodhimeve muzikore, video, audio, librave, gazetave, revistave që lidhen me programet e RTK-së;
- Veprimtaritë koncertale dhe shfaqjet publike;
- Reklammat dhe publikimet e mesazheve tjera të paguara;
- Sponzorizimet dhe donacionet në pajtim me ligjin;
- Shitja e programeve të RTK-së;
- Burimeve tjera në pajtim me Ligjin

RTK-ja kryen veprimtarinë e vet përmes fondeve të mbledhura nga Parapagimi dhe nga burimet tjera të financimit, të cilat i ka të depozituara si para publike në tërësinë e tyre në një xhirollogari të caktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Të gjitha të hyrat e RTK-së shfrytëzohen për financimin e programeve të Radio Kosovës dhe Televizionit të Kosovës dhe për qëllime tjera në pajtim me planet vjetore programore, dhe financiare të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së.

Buxhetin vjetor të RTK-së, duke përfshirë skemën e pagave të Menaxhmentit dhe të të punësuarve tjerë si dhe amortizimin, e miraton Bordi i Drejtorëve të RTK-së, në bazë të propozimit të Menaxhmentit të RTK-së, gjithnjë duke pasur kujdes që shpenzimet nuk i tejkalojnë burimet e tyre të financimit (të hyrat).

#### IV. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

ZAGJ ka kryer auditimin e të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin e përfunduar me 31.12.2007.

Objektivë primare e këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAGJ-së të raportojë se si RTK-ja ka menaxhuar me të hyrat dhe shpenzimet gjatë vitit fiskal që përfundon me 31.12.2007, për të vërtetuar nëse grumbullimi i të hyrave respektivisht shpenzimi i tyre kishte ndodhur në pajtim me ligjet dhe rregulloret aplikative mbi RTK-në, si dhe nëse është bërë regjistrimi i saktë dhe i plotë i transaksioneve të ndodhura gjatë vitit për të mundësuar raportimin e

besueshëm të aktiviteteve financiare të RTK-së në bazë të Sistemit aktual të kontabilitetit të përcaktuara me Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

## VI. QASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë i të hyrave dhe i shpenzimeve të RTK-së për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007 është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të hartuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Bordi funksionon si një organ përcaktues për standardet ndërkombëtare, nën patronazhin e FNK-së. SNA-të vendosin kornizën ndërkombëtare në kuadër të së cilës ZAGJ kryen aktivitetin e sajë dhe mbulon çështje si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve si dhe konkluzionet dhe raportimi mbi auditimin.

Auditimi ynë ishte planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 14.04.2008 deri më 16.05.2008. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive tona, ne:

- Kemi rishikuar raportet e brendshme financiare të RTK-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse regjistrimi kontabël i transaksioneve ka ndodhur si dhe nëse raportet financiare të RTK-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP-të " Raportimi Financiar në bazë të Sistemit Aktual të Kontabilitetit ";
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

- Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në kuadër të RTK-së, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë ;

*Nëse është e përshtatshme, raporti i auditimit duhet t'i diskutojë cilatdo kufizime lidhur me auditimin, siç është moslejimi i qasjes në shënime, mungesa e dokumentacionit, pamundësia për të vizituar vendndodhjet e projektit, etj, si dhe ndikimin e kufizimeve të tilla në vetë auditimin.*

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Është e mundur që informata shtesë mund të kenë ekzistuar, që nuk na janë siguruar neve, të cilat po të na siguroheshin do të kishin mundur të ndryshonin të gjeturat tona të auditimit.

## VI. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KYÇE

Më poshtë kemi paraqitur të gjeturat dhe rekomandimet kyçe, si rezultat i auditimit tonë bërë të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së për vitin që përfundon më 31.12.2007.

### Menaxhimi Financiar

Sistemi i raportimit financiar të RTK-së duke përfshirë menaxhimin e parasë (Cash-it) rregullohet sipas Politikave Financiare dhe Statutit të RTK-së të nxjerra në bazë të Ligjit mbi RTK-në.

RTK-ja bën regjistrimin e transaksioneve kontabël sipas sistemit të kontabilitetit të dyfishtë, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat i referohen bazës akruale të llogarimbajtjes. Përveç Raporteve Vjetore financiare, RTK-ja përgatitë edhe raporte financiare periodike për nevoja të brendshme të raportimit.

Sipas Ligjit dhe rregullave të brendshme të RTK-së, të gjitha të hyrat e mbledhura nga parapagimet dhe nga burimet tjera të financimit duhet të depozitohen si para publike në tërësinë e tyre në një xhirologari të caktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Deri në Qershor të vitit 2008, RTK-ja ka mbledhur të hyrat nga parapagimet për transmetim publik përmes Bankës Qendrore si dhe të hyrat nga burimet tjera përmes bankës komerciale ProCredit Bank. Prej Qershorit menaxhimi i të gjitha të hyrave bëhet përmes ProCredit Bank.

Sa i përket pagesave, ato kryhen direkt përmes llogarisë bankare, me bartje direkte të parave përmes urdhërpagesës (transferit) apo përmes dhënies (lëshuarjes në qarkullim) të çeqeve.

Pagesat përmes transferimit kryhen vetëm me aprovim të së paku 2 anëtarëve të menaxhmentit të lartë të cilët me autorizim të Drejtorit të përgjithshëm e bëjnë deponimin e nënshkrimit në bankën përkatëse.

#### E gjetura:

Në kundërshtim me kërkesat, që të gjitha paratë publike duhet të deponohen në një llogari të përcaktuar nga MEF, RTK-ja gjatë vitit 2007 kishte 2 llogari kryesore dhe 5 nënlllogari bankare të cilat ishin shfrytëzuar për depozita dhe pagesa. Njëra nga këto nënlllogari ishte hapur me kërkesë të Donatorit.

Që nga fillimi i vitit 2008, RTK-ja ka ristrukturuar llogaritë e saja në 2 llogari kryesore si dhe një nënlllogari për projektin " Rruga Sezam".

#### Konkluzion:

Llogaritë e shumëfishta bankare shpijnë drejtë dobësimin të kontrollit mbi të hyrat dhe shpenzimet. Po ashtu, vështirëson përcjelljen dhe menaxhimin e rrjedhës së parasë së gatshme në mënyrë të saktë.

Me kënaqësi ju raportojmë se Menaxhmenti i RTK-së ka reduktuar numrin e llogarive bankare në vitin 2008.

#### Rekomandimi I:

RTK-ja duhet të menaxhojë llogaritë e sajë bankare në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe operative të Organizatës.

#### Të hyrat e RTK-së

Radiotelevizioni i Kosovës si Institucion i Pavarur publik transmetues financohet nga të hyrat vetanake të gjeneruara nga 4 lloje burimesh kryesore si në vijim:

1. Të hyrat nga Parapagimi për Transmetuesin Publik	7,991,363,00 €	(81 %)
2. Të hyrat nga Marketingu	1,526,519,00 €	(16 %)
3. Të hyrat nga Shërbimet	189,098,00 €	(2 %)
4. Të hyrat tjera	105,302,00 €	(1 %)
<b>Totali</b>	<b>9,812,282,00 €</b>	<b>(100%)</b>

## Të hyrat nga parapagimi

Sipas Ligjit mbi Radiotelevizionin e Kosovës Nr.02/L-47, burimi kryesor i financimit të aktiviteteve të RTK-së janë të hyrat nga parapagimi i qytetarëve për shërbimet e kryera të transmetimit.

Sipas autorizimeve ligjore, të hyrat e RTK-së nga parapagimi grumbullohen nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e cila operon si agjent i mbledhjes së parapagimit brenda territorit të Kosovës në bazë të Kontratës së datës 18.11.2005 të nënshkruar mes RTK-së dhe KEK-ut.

Tarifa e parapagimit është në vlerë prej 3,5 € në muaj për çdo amvisëri ose biznes të regjistruar të cilit KEK-u ia dërgon një faturë elektrike. KEK-u është i obliguar që ti deponojë në bazë mujore tarifat e mbledhura në një xhirollogari të RTK-së më së voni deri në ditën e 10 të muajit vijues. Derisa në emër të provizionit, KEK-u ndal çdo muaj 6 % nga totali i mbledhur mujor për shërbimet e ofruara ndaj RTK-së plus TVSH-në.

Shuma e të hyrave nga parapagimi të mbledhura nga ana e KEK-ut në emër të RTK-së për vitin 2007 ishte 7,991,363.00€ bruto apo 7,439,959€ neto pas zbritjes së provizionit ndaj KEK-ut respektivisht TVSH-së në vlerë prej 551,404.00€.

Deri më 31 Dhjetor 2007 KEK-u ka transferuar në xhirollogarinë e RTK-së 5,332,598.00€ sa i përket grumbullimit të parapagimeve për Transmetuesin Publik për vitin 2007.

## E gjetura:

Në kundërshtim me kontratën në mes RTK-së dhe KEK-ut që tarifat e mbledhura mujore të transferohen brenda 10 ditëve të muajit vijues, transferimi i mjeteve në xhirollogari ishte bërë vazhdimisht me vonesa për disa muaj.

## Shembull

Tarifat e mbledhura gjatë muajit janar 2007 prej 690,244.00€ është dashur që KEK-u ti transferojë në xhirollogari të RTK-së më së voni deri më 10 Shkurt 2007. Derisa kjo shumë ishte transferuar me vonesë në 4 data të ndryshme, dhe atë:

	Shuma Neto e paguar	Data e pagesës	Vonesa në Ditë
1.	250,244€	03.04.2007	52 ditë,
2.	240,000€	24.04.2007	73 ditë,
3.	60,000€	25.04.2007	74 ditë,
4.	140,000€	16.05.2007	95 ditë.

Kjo kontratë për shërbim nuk ka ndonjë provizion për zbatimin e ndëshkimeve financiare në rast të vonesës në transferim të parave nga KEK-u në RTK.

**Konkluzion:**

Vonesa në transferimin e mjeteve nga KEK-u në RTK është shkelje direkte e kontratës. Për më tepër, këto vonesa kanë ndikim direkt në rrjedhën e parasë së RTK-së dhe mund të ndikojnë në aktivitetet e saja. Kontrata për shërbim e kësaj natyre, normalisht do të pritej që të ketë një provizion për zbatimin e ndëshkimeve financiare me rastin e vonesës së transfereve të parave të dërguara.

**Rekomandimi 2 :**

KEK duhet formalisht të përmbush obligimin e vet kontraktues që të mbajë parapagimin e Transmetuesit Publik në emër të RTK-së brenda 10 ditëve të muajit që pason me mbledhjen e parapagimeve të përmendura.

RTK-ja duhet të ri-negociojë kontratën e sajë për shërbim me KEK-un në mënyrë që të përfshijë një provizion të përshtatshëm për zbatimin e ndëshkimeve financiare në rastet e transfereve të të hyrave nga parapagimet për Transmetuesin Publik prej KEK-ut në RTK.

**Komentet e Menaxhmentit të RTK-së:**

1. Në faqen 10, në Konkluzion të Rekomandimit 2, në Draft Raportin e Auditimit të të Hyrave dhe Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin përfundimtar me 31/12/2007, sqarojmë si në vijim:
  - a) Qëndron fakti se vonesa në transferimin e mjeteve nga KEK-u në RTK është shkelje direkte e kontratës nga ana e KEK-ut, përkatësisht të paragrafit 5.1, të Nenit 5, Deponimi i Mjeteve të Mbledhura nga Paragimi për RTK-në.
  - b) RTK-ja disa herë i është drejtuar me shkrim KEK-ut me kërkesë që të bëjë pagesën e obligimeve në përputhje me kontratën ekzistuese, në të kundërtën RTK është e përgatitur të ndër marr veprime ligjore me qëllim të inkasimit të borxheve të RTK-së. (korrespondenca e bashkangjitur)
  - c) Kontrata aktuale RTK-KEK skadon me 30 nëntor 2008. RTK-ja do ta ketë parasysht që në rinegocimin e kontratës RTK-KEK e cila parashihet të fillojë së shpejti, të inkorporohet neni për zbatimin e ndëshkimeve financiare në raste të transfereve të vonuara të të hyrave nga parapagimet prej KEK-ut në RTK.

**Vlerësimi i ZAGJ-së :**

RTK-ja pajtohet me të gjeturat e ZAGJ-së, përderisa komentet e sjella nga RTK-ja kanë të bëjnë me veprimet të cilat do të ndërmerren lidhur me implementimin e rekomandimeve.

### Të hyrat nga marketingu

RTK-ja ka kontraktuar "CMB Productions & Marketing" si agjent të sajë për realizimin e të hyrave nga shitja e hapësirës reklamuese. Për këtë shërbim, CMB-ja paguhet me provizion bazuar në vlerën e të hyrave të gjeneruara nga ky burim.

Euro	Provizioni
Deri 1,300,000	10%
Prej 1,300,000 deri 1,500,000	15%
Mbi 1,500,000	20%

Të hyrat e realizuara nga marketingu për vitin 2007 ishin 1,526,518.74€, prej tyre 1,519,620.10€ ishin realizuar nga CMB-ja, derisa pjesa tjetër prej 6,898.64€ ishte realizuar përmes Radios. Provizioni që i është paguar CMB-së për shërbimet e kryera lidhur me inkasimin e të hyrave për vitin 2007 ishte 168,933€. (përfshirë TVSH-në). Ky shpenzim është klasifikuar nën "Mallra dhe Shërbime" në pasqyrat e të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së.

### Konkluzion:

Për të siguruar një konsistencë për sa i takon raportimit financiar do të ishte e preferueshme nëse provizionet e paguara për agjencitë në lidhje me shërbime marketingu, të identifikoheshin qartë dhe ndaras në pasqyrat financiare të RTK-së. Kjo tashmë bëhet me provizionet që paguhet për CMB-në dhe ndryshim ynë i rekomanduar do të sjellë transparencë dhe konsistencë në raportim.

### Rekomandimi 3:

Bordi i RTK-së duhet të mendojë për korrigjimin e raporteve financiare në mënyrë që të tregojë provizionet e paguara për të hyrat nga Marketingu si një artikull të ndarë dhe jo si praktika aktuale që i raportojnë si shpenzime në kategorinë "Mallra dhe Shërbime".

### Komentet e Menaxhmentit të RTK-së :

2. Në faqen 11, në Konkluzion të Rekomandimit 3, në Draft Raportin e Auditimit të të Hyrave dhe Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin përfundimtar me 31/12/2007, sqarohet si në vijim:

- a) Në Raportin e detajizuar Financiar Vjetor të RTK-së për vitin 2007, i cili është shqyrtuar dhe aprovuar nga ana e Bordit të Drejtorëve të RTK-së, kopja e së cilës i është dorëzuar Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Pushtetin Lokal dhe Media, shpenzimet e provizionit të Marketingut janë pasqyruar si vijë e veçantë. Shpenzimet e provizionit të marketingut të RTK-së

janë të paraqitura si vijë e veçantë edhe në pasqyrat e publikuara në web faqe të RTK-së (www.rtklive.com).

- b) Në mbledhjen e radhës të Bordit të Drejtorëve të RTK-së, Menaxhmenti i RTK-së do të rekomandojë që provizionet e paguara për të hyrat nga Marketingu të paraqitet si një artikull i ndarë.

#### Vlerësimi i ZAGJ-së:

RTK-ja pajtohet me të gjeturat e ZAGJ-së, përderisa komentet e sjella nga RTK-ja kanë të bëjnë me veprimet të cilat do të ndërmerren lidhur me implementimin e rekomandimeve.

#### Shpenzimet e RTK-së

Shpenzimet e RTK-së për vitin 2007 ishin 9,680,150€ . Me qëllim të shpjegimit më detal të shpenzimeve, në vijim kemi paraqitur ndarjen e tyre sipas kategorive kryesore:

Kategoria	Shuma në €	% në total
1. Pagat dhe Mëditjet	3,544,783	37%
2. Investimet Kapitale	1,525,310	16%
3. Subvencione dhe Transfere	583,823	6%
4. Mallra dhe Shërbime	3,813,865	39%
5. Shpenzimet Komunale	212,369	2%
Totali	9,680,150	100%

#### Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2007 RTK kishte 423 të punësuar me kontrata të rregullta.

Përveç kësaj, RTK kishte angazhuar punëtorë tjerë me kontrata mbi vepër dhe kontrata mbi bashkëpunimin profesional me qëllim të realizimit të projekteve të veçanta për nevojat e sektorëve dhe redaksive të ndryshme programore.

#### E gjetura:

Rregulloret e brendshme të RTK-së lejojnë angazhimin e bashkëpunëtorëve profesional në bazë të planit vjetor për produksion. Ky plan është aprovuar nga Bordi i RTK-së. Njësia e Burimeve Njerëzore të RTK-së përgatitë dhe publikon konkurset për punëtor me honorar dhe bën rekrutimin e kësaj kategorie duke aplikuar procedurat standarde të rekrutimit.

Në raste të jashtëzakonshme, Drejtori i përgjithshëm i RTK-së mund të angazhojë drejtpërsëdrejti bashkëpunëtor me honorar në konsultim me Udhëheqësit relevant të njësive.

Në vitin 2007, është angazhuar bashkëpunëtori profesional për çështje juridike për të ofruar shërbime juridike të parapara në organogramin e RTK-së nga ana e njësisë permanente juridike. Bordi i RTK-së mori këtë vendim duke u bazuar në pohimin e tyre se ata nuk do të jenë në gjendje të rekrutojnë një këshilltar juridik me orar të plotë brenda strukturës së pagave të RTK-së. Për këtë, sa herë që paraqitej nevoja, ata angazhonin një këshilltar juridik duke përdorur kontrata për shërbim.

#### **Konkluzion:**

Derisa ne mund ti kuptojmë vështirësitë që i ka RTK-ja në rekrutimin dhe mbajtjen e zyrtarëve juridik me kualifikim të duhur dhe me eksperiencë do të ishte e preferuar nëse ata do të ishin në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë. Në mënyrë alternative, RTK-ja duhet të kërkojë aprovimin e plotë nga ana e Bordit për të rregulluar strukturën e saj organizative në mënyrë që të reflektojë faktin se nuk është e mundshme të ketë një shërbim permanent juridik, dhe si zëvendësim RTK-ja do të përdor bashkëpunëtor për të ofruar shërbime juridike.

#### **Rekomandimi 4:**

RTK-ja duhet ose të kërkojë në mënyrë aktive rekrutimin e zyrtarëve ligjor që të themelojnë njësinë permanente juridike të RTK-së ose të kërkojë aprovimin e plotë të Bordit që të rregullojë organogramin aktual në mënyrë që të reflektojë faktin se rekrutimi për këtë njësi është i pamundshëm.

#### **Komentet e Menaxhmentit të RTK-së :**

3. Në faqen 13, në Konkluzion të Rekomandimit 4, në Draft Raportin e Auditimit të të Hyrave dhe Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin përfundimtar me 31/12/2007, sqarojmë si në vijim:

Në mbledhjen e rregullt të Menaxhmentit të RTK-së më 10 shtator 2008, është marr vendimi për shpalljen e konkursit zyrtar për rekrutimin e dy zyrtarëve ligjor në kuadër të Njesisë Ligjore në RTK. ( konkursi i shpallur në [www.rtklive.com](http://www.rtklive.com) )

#### **Vlerësimi i ZAGJ-së :**

RTK-ja pajtohet me të gjeturat e ZAGJ-së, përderisa komentet e sjella nga RTK-ja kanë të bëjnë me veprimet të cilat do të ndërmerren lidhur me implementimin e rekomandimeve.

## **Prokurimi**

### **E Gjetura:**

Siç kërkohet me nenin 7.2 të Ligjit mbi Prokurim Publik 2003/17, Menaxhmenti i Lartë i RTK-së duhet të dorëzojë planin vjetor të prokurimit në APP. Kjo nuk është bërë dhe të gjitha prokurimet e vitit 2007 janë kryer në bazë të planit fillestar të pa aprovuar.

Zyrtari i prokurimit të RTK-së përgjegjës për prokurimet e Radios nuk posedon asnjë dëshmi të trajnimit të duhur ashtu siç kërkohet me nenin 21.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

### **Konkluzioni:**

Mungesa e planit të aprovuar përfundimtar të prokurimit të APP lidhur me faktin se zyrtari i prokurimit të Radios nuk ka kaluar nëpër trajnimin e nevojshëm mund të dobësojë menaxhmentin për të gjitha proceset e prokurimit.

### **Rekomandimi 5:**

Menaxhmenti i RTK-së duhet të sigurojë se ekziston pajtueshmëri e plotë me kërkesat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.

### **Komentet e Menaxhmentit të RTK-së :**

4. Në faqen 13, në Konkluzion të Rekomandimit 5, në Draft Raportin e Auditimit të të Hyrave dhe Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin përfundimtar më 31/12/2007, sqarohet si në vijim:

- a) Me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë së plotë me kërkesa të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë emëruar zyrtar të prokurimit të RTK-së të cilët do të përfshihen në trajnimin, ashtu siç parashihet me nenin 21.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

### **Vlerësimi i ZAGJ-së :**

RTK-ja pajtohet me të gjeturat e ZAGJ-së, përderisa komentet e sjella nga RTK-ja kanë të bëjnë me veprimet të cilat do të ndërmerren lidhur me implementimin e rekomandimeve.

### **Shpenzimet e Udhëtimit**

### **E gjetura:**

Në kundërshtim me politikat financiare të RTK-së, një avans paraprak prej 1000 € për udhëtime zyrtare është mbyllur 2 muaj pas kthimit nga udhëtimi e jo në maksimum prej 8 ditëve siç kërkohet me rregullat e brendshme.

Këto rregulla të njëjta lejojnë që RTK-ja të heq avanset e vonuara nga pagat e punëtorëve. Në këtë rast një veprim i tillë nuk është iniciuar.

#### **Konkluzioni:**

Vonesat e raportuara të mbylljes së avanseve janë në kundërshtim direkt me politikat e aprovuara të RTK dhe mund të shfaqin dobësi në menaxhimin e fondeve të RTK-së.

#### **Rekomandimi 6:**

Menaxhmenti i RTK-së duhet që në mënyrë rigoroze të aplikoj politikat dhe procedurat e saja kur ka të bëjë me mbylljen e avanseve të stafit.

#### **Trajnimi i Stafit**

##### **E Gjetura:**

Në prill 2007 RTK-ja kishte nënshkruar kontratën mbi shërbime me Shkollën e Dizajnit dhe të Modës " Design Factory-KS ". Me këtë kontratë parashihej që një i punësuar i RTK-së të vijojë studimet tre vjeçare pa pagesë pranë kësaj shkolle, derisa RTK-ja obligohej që si kompensim ti ofrojë hapësirë reklamuese aktiviteteve të kësaj shkolle për çdo vit akademik deri në diplomimin e kandidatit duke mos e precizuar vlerën monetare të Kontratës.

Gjatë periudhës së auditimit Maj 2008, neve nuk na është ofruar asnjë dëshmi që do të vërtetonte nëse ndonjë i punësuar i RTK-së kishte filluar vijimin e studimeve në këtë shkollë, derisa me datë 02.10.2007 shkolla "Design Factory-KS" kishte faturuar RTK-në në vlerë prej 15,400.00€ për tri vite të studimeve.

Për më tepër, RTK i kishte mundësuar kësaj shkolle që ta shfrytëzonte tërë hapësirën reklamuese (vlera e reklamave 15,400.00€) brenda vetëm 2 muajve edhe pse me kontratë ishte përcaktuar që reklamimi të bëhej për periudhën tri vjeçare.

#### **Konkluzioni:**

Ne konkluduar se kjo kontratë nuk i është ofruar RTK-së me shërbimet e pritura dhe RTK-ja nuk do të duhej ti autorizonte shkollës, hapësirën e lirë reklamuese. Si rezultat i veprimeve të tyre, konkluduar se RTK-ja potencialisht ka humbur të hyrat nga reklamimi në vlerë prej 15,400.00€.

#### **Rekomandimi 7:**

Menaxhmenti i RTK-së duhet të sigurojë që punëtori/ja e RTK-së të caktohet menjëherë në mënyrë që të vijoj në studimet tri vjeçare të parapara në këtë kontratë. Në mënyrë

alternative, Menaxhmenti i RTK-së duhet të hetojë rrethanat e kësaj humbje të mundshme të të hyrave dhe të ndër marrë veprime të duhura.

Komentet e Menaxhmentit të RTK-së :

5. Në faqen 14, në Konkluzion të Rekomandimit 6, në Draft Raportin e Auditimit të të Hyrave dhe Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin përfundimtar me 31/12/2007, sqarojmë si në vijim:
- a) Në kontratë të nënshkruar në mes të RTK-së dhe fakultetit " Design Factory" për shkollimin e një të punësuarë të RTK-së në këtë fakultet, vijimi shkollimit është paraparë të fillojë nga viti akademik 2007.
  - b) Për shkaqe shëndetësore e punësuarë e RTK-së nuk ka mundur të vijojë mësimet në fakultetin e lartpërmendur. ( dokumente mjekësore të arkivuara gjenden në zyrën e administratës së RTK-së)
  - c) Nga ana e fakultetit "Design Factory" RTK-ja është informuar se i njëjti ka lidhur kontratë me një universitet të licencuar në Maqedoni, fakt ky që e mundëson RTK-në të nominojë një të punësuar tjetër për vijim të shkollimit në fakultetin "Design Factory" për tri vitet e ardhshme akademike në studime bachelor.

Vlerësimi i ZAGJ-së :

RTK-ja pajtohet me të gjeturat e ZAGJ-së, përderisa komentet e sjella nga RTK-ja kanë të bëjnë me veprimet të cilat do të ndërmerren lidhur me implementimin e rekomandimeve.

## VII. AUDITIMI I BRENDSHËM

Shërbimi i pavarur, funksional dhe efektiv i Auditimit të brendshëm është komponentë kyçe e sistemit të kontrollit të brendshëm. Vepron si një këshilltar për Menaxhmentin e Lartë mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme në parandalimin dhe detektimin e parregullsive dhe mashtrimet e mundshme. Po ashtu, do të sigurojë Menaxhmentit rekomandime të dizajnuara për të përmirësuar ambientin e kontrollit të brendshëm.

**Të gjeturat:**

Në vitin 2007 RTK-ja kishte një auditor të brendshëm i cili në këtë vit kishte kryer dy auditime.

Këto auditime janë kryer në pajtueshmëri me planin vjetor të punës dhe raportet pasuese ofruan rekomandime të dobishme në mënyrë që të korrigjohen dobësitë e identifikuar;

#### **Konkluzioni:**

Meqë aktivitetet e planifikuara dhe aktuale të auditimit nuk kanë mbuluar aktivitetet e rëndësishme operationale dhe financiare të RTK-së dhe nuk ishin bazuar në asnjë analizë të rrezikut, konkluduar se nuk mund të mbështetemi në punën e auditimit të brendshëm të RTK për qëllimet e rishikimit tonë.

#### **Rekomandimi 8:**

Menaxhmenti i RTK-së duhet të përpiqet të përmirësojë shërbimin e auditimit të brendshëm që aktualisht i sigurohet RTK-së duke siguruar që auditimet e planifikuara bazohen në vlerësimin e rrezikut që do të identifikonte fushat prioritare të auditimit.

Menaxhmenti i RTK duhet të mendojë për rekrutimin e personelit shtesë të përshtatshëm, të kualifikuar dhe me eksperiencë në mënyrë që të forcojë dhe zgjerojë aktivitetet e shërbimit të auditimit të brendshëm.

#### **Komentet e Menaxhmentit të RTK-së :**

6. Në faqen 16, në Konkluzion të Rekomandimit 8, në Draft Raportin e Auditimit të të Hyrave dhe Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin përfundimtar me 31/12/2007, sqarojmë si në vijim:

- a) Gjatë vitit 2007 Menaxhmenti i RTK-së përkundër diskutimeve të vazhdueshme mbi nevojën e personelit shtesë në shërbimin e Auditimit të Brendshëm të RTK-së për shkaqe të pasigurisë buxhetore si pasojë e njoftimit arbitrar nga ana e KEK-ut për shkëputje të njëanshme të kontratës RTK-KEK, RTK-ja nuk ka mundur të rekrutojë dhe mbulojë shpenzimet për staf shtesë në shërbimin e Auditimit të Brendshëm të RTK-së. (bashkangjitur njoftimi për shkëputje të kontratës RTK-KEK)
- b) Nisur nga Rekomandimi 8, në Draft Raportin e Auditimit të të Hyrave dhe Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin përfundimtar me 31/12/2007, Menaxhmenti i RTK-së ka marrë vendim të shpallë konkurs për rekrutimin e stafit shtesë në shërbimin e Auditimit të Brendshëm të RTK-së. (konkursit i shpallur në [www.rtklive.com](http://www.rtklive.com))

#### **Vlerësimi i ZAGJ-së :**

RTK-ja pajtohet me të gjeturat e ZAGJ-së, përderisa komentet e sjella nga RTK-ja kanë të bëjnë me veprimet të cilat do të ndërmerren lidhur me implementimin e rekomandimeve.

Aneksi I - Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2007

**Bilanci i suksesit të RTK, sipas gjendjes 31 dhjetor 2007**

Nr.	TË HYRAT	EURO	SHPENZIMET	EURO
1	Të hyrat nga parapagimi	7,991,363	Pagat dhe mëditjet	3,544,783
2	Të hyrat nga marketingu	1,526,519	Programi	2,312,091
3	Rimbursimet	189,098	Amortizimi	909,633
4	Të hyrat tjera	65,668	Investimet	615,677
5	Të hyrat nga donatorët	39,634	Mallra dhe shërbime	604,573
6			Subvencione dhe transfere	583,823
7			Provizioni ndaj KEK-ut	496,401
8			Karburanti dhe mirëmbajtja	220,630
9			Shpenzimet komunale	212,369
10			EBU dhe Fidat	146,362
11			Të tjera	33,808
	<b>Total të hyrat</b>	<b>9,812,282</b>	<b>Total shpenzimet</b>	<b>9,680,150</b>

Total të hyrat 9,812,282€

Total shpenzimet 9,680,150€

Diferenca pozitive 132,132€